Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01/29
Datë 25.04.2014

Në mbështetje të neneve 6 dhe 16 të Ligjit nr. 03/L-060 mbi Kualifikimet Kombëtare të datës 7 nëntor 2008 dhe Udhëzimit Administrativ nr. 1/2011- Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me nenet 4,7,10 dhe 16, vendimit të KD-së me numër 470/13 të datës 23.10.2013, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve me datë 25.04.2014 nxjerr këtë:

VENDIM

1. Për akreditimin e Institutit për Banka dhe Financa, Prishtinë për periudhën 25.04.2014 – 25.04.2016 për këtë kualifikim të aprovuar :

   1.1. Nëpunës i Shërbimeve Bankare, niveli III i KKK-së.

2. Arsyetim

Këshilli Drejtues i AKK-së merr këtë vendim bazuar në rekomandimet të dala nga Raportet mbi kushtet e vendosura nga KD i AKK-së.

3. Vendimi hyn në fuqi me datën e nënshkrimit të tij.

4. Vendimi u dërgohet:

- IBF- Prishtinë;
- AKK-së.

Kryetari i KD së AKK-së
Ragip Gjoshi